

## **PROCESVERBAL 19/2023**

I mbajtur me rastin e takimit të 9 (nëntë) të rregullt për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 19.10.2023 duke filluar nga ora 9:00.

### **Rend dite**

**1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi” ;**

**3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022;**

**4.Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

### **Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

### **Aprovohet pika 1**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi” ;**

**Avni Bytyqi** - tashmë çështja e çmimit “Ukë Bytyçi” është bërë tradicionale në Komunën tonë.Këtë vit Kryetari i Komunës ka propozuar biznesmenin z.Mufail Gashi për çmimin Ukë Bytyçi i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për Komunën tonë.Komisioni e ka shqyrtuar propozimin dhe ka ardhë në përfundim që këtë propozim ta dërgoj në Kuvend.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

### **Aprovohet pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022;**

**Avni Bytyqi** - është kërkesë e anëtares së komisionit znj.Sanie Kuçi Rexhepaj e cila ka dhënë dorëheqje nga ky komision. Komisioni ka të bëjë me ndarjen dhe definimin e banesave të objektit të cilin e ka dhënë Kuvendi në shfrytëzim për ndërtimin e objektit afaristo banesor.Andaj ne jemi të obliguar që ta bëjmë plotësim-ndryshimin e anëtarit të komisionit.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

### **Aprovohet pika 3**

#### **Pika 4. Të ndryshme;**

**Kryesuesi** - dua të ju informoj që të hënën kemi qenë për vizitë në shollën "Drita". Kemi bisedu me drejtoreshën e shkollës dhe ajo më tregoi për problemet në shkollë. Ishin 4 apo 5 familje të cilët fëmijët e tyre po i dërgojnë në shkollë por disa fëmijë e vijnë në mësimin, disa rrinë në korridore dhe nuk hyn në klasë e disa dalin nga shkolla. Në atë shkollë ish një organizatë joqeveritare që po mbanë mësim plotësues dhe ne si komitet propozojmë me mbajtë një ligjëratë vetëdijësuese me anëtarët e familjes së atyre fëmijëve. Tutorët mund të zhvillojnë ligjëratën në kuadër të mësimin por ne kërkojmë që Komuna ta dërgojë një anëtarë nga Komuna ose nga Drejtoria e Arsimit që të mbajnë një ligjëratë me ata anëtarë të familjes dhe me i tregu se sa i rëndësishëm është mësimi dhe që është përgjegjësi e tyre që fëmijët të vijnë në mësimin dhe që mund të ndiqen edhe penalisht nëse fëmija i tyre nuk e kryen shkollën filllore. Gjithëashtu kemi edhe zyrtaren për barazi ligjore e cila ka një përvojë të mirë sa i përket arsimit ku mund të ia kushtoj një orë dhe bashkë me dy tutorët me mbajtë një ligjëratë me prindër dhe me i tregu që ata e kanë obligim ligjor që fëmijët e tyre të vijnë në mësimin. Gjithëashtu drejtoresha e shkollës më tha që shumë familjarë i sjellin fëmijët në shkollë javën e parë që me mujt me marrë vërtetimin e shkollës i cili i duhet për procedurat e skemave sociale.

**Habibe Bytyqi** - realisht tema e cila po diskutohet është një shqetësim që e kam ngrit unë. Kam qenë në vizitë në atë shkollë dhe të gjitha problemet që po i thoni ju, i kam pa. Nuk e kundërshtoj idenë tuaj por unë hezitohet në sukses të asaj ligjerate. Drejtoresha e asaj shkolle ka provu të gjitha format por nuk ka pas sukses dhe ideja ime në atë takim ka qenë që ju me shku me bisedu me familjet dhe jo me shkollën sepse problemi është te familja. Familjet nuk e kanë të qartë që kjo është obligim ligjor. Tash jemi në pikën që çka duhet me vendos apo ndoshta janë shterrë të gjitha mundësitë dhe duhet me fillu me u marrë me ligjin.

**Avni Bytyqi** - sa e kuptova, nuk ka të bëjë ajo që familjet nuk po i dërgojnë fëmijët në shkollë por ju thotë që fëmijët po i dërgojnë në shkollë por fëmija nuk po rrinë në orë të mësimin dhe ne nuk mund të marrim asnjë masë ndaj familjes. Mundohuni me gjetë ndonjë mekanizëm që fëmijët pak me i detyru me qëndru brenda në shkollë dhe jo me dal. Tash po përdorën format e demokracisë që fëmija mund të bëjë çka të dojë dhe si pasojë e kësaj ja çka po ndodh sot. Ju si komitet bëni si ta shihni të arsyeshme. Propozimi im është që me pas ju një takim me familjarët në prezencën e fëmijëve.

**Habibe Bytyqi** - unë nuk e konsideroj që realizohet një e drejtë duke e shkel një të drejtë tjetër.

**Nazim Shabanaj** - unë kam shku shtëpi për shtëpi.

**Aziz Bytyqi** - ne ishim në vizitë dhe gjendja nuk është alarmante sa po e alarmojmë ne këtu. Problemi mbi të gjitha për mua është human. Drejtoresha e dha vullnetin e vet dhe nuk është gjë e keqe që ne ta mbajmë një ligjëratë. Unë e kam vullnetin me shku me mbajtë ligjëratë, si për aspektin ligjor si për aspektin human. Çdo institucion ka rregulla, ka sanksione, ka masa ndëshkuese në kuptimin ligjor por ka edhe dhunë të kufizune me pëlqimin e prindit.

**Kryesuesi** - ju që po e thoni këtë, është masa e fundit që duhet me bo. Ne po dojmë që me këtë lloj ligjerate me ia kalu prindit si përgjegjësi. Ligjeratën që unë po e propozoj, te ne si mentalitet është ndryshe kur mua t' më thotë Nazimi dhe ndryshe kur t' vje dikush nga Komuna sepse ata e kanë një farë frike. Nëse vje dikush nga Komuna dhe ia sqaron që prindi është përgjegjës për fëmijën e tij deri në klasë të nëntë dhe patjetër duhet të vijojë mësimin, atëherë prindi e merr pak për bazë.

**Avni Bytyqi** - këtë propozim e pata dhe unë. Prind-nxënësa-mësimdhënës. Prindërit në prezencën e fëmijëve pak me iu dhënë të drejtën edhe mësimdhënësve se si me mujt me i rehabilitu në klasë. Si do që të vendosni Komuna është e gatshme të iu ndihmojë.

**Aziz Bytyqi** - unë jam i gatshëm të iu ndihmojë.

Takimi përfundoi: 09:35